

Njoftim për përqendrim me të cilin MAKEDONIJATURIST Shkup do të fitojë të drejtën e qirasë mbi pjesën hoteliere të kompleksit sportiv „Jane Sandanski“ Shkup (Lënda nr. 08-114/2026)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 17.07.2026, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin **Shoqëria Aksionare për Hoteleri dhe Gastronomi MAKEDONIJATURIST Shkup**, me seli të regjistruar në rr. „Filipi i Dytë i Maqedonisë“ nr. 5, Shkup-Qendër, do të fitojë të drejtën e qirasë (shfrytëzimit) të pasurisë së paluajtshme që paraqet pjesën hoteliere të kompleksit sportiv „Jane Sandanski“, me të cilin administron **Shoqëria për Sport dhe Rekreacion „QENDRA SPORTIVE JANE SANDANSKI“ SHPKNJP Shkup**, me seli të regjistruar në Bulevardin „ASNOM“ nr. 1, Shkup-Aerodrom, NUAS 6837093, NUT 4057012520022.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe veprimtaritë e tyre afariste:

Shoqëria Aksionare për Hoteleri dhe Gastronomi MAKEDONIJATURIST Shkup, MAKEDONIJATURIST Shkup është shoqëri aksionare në pronësi të disa aksionarëve, veprimtaria e së cilës është ofrimi i akomodimit hotelier në qytetin e Shkupit. Shoqëria Aksionare për Hoteleri dhe Gastronomi MAKEDONIJATURIST Shkup, në portofolin e saj ka 4 (katër) hotele, edhe atë: Holiday Inn Shkup me 5 yje, Hotel Turist me 4 yje, Hotel Karposh me 4 yje dhe Hotel Bellevue me 4 yje. Markat hoteliere kanë liri të jenë të qarta dhe të dallueshme, ndërsa grupi siguron ombrellën e besueshmërisë dhe standardit. Krahas hoteleve, shoqëria administron edhe restorante dhe kapacitete për kongrese në kuadër të hoteleve.

Shoqëria për Sport dhe Rekreacion „QENDRA SPORTIVE JANE SANDANSKI“ SHPKNJP Shkup ka lidhur Marrëveshje për themelimin e partneritetit publiko-privat lidhur me ndërtimin e kompleksit sportiv „Jane Sandanski“ me partnerin publik, Komunën e Aerodromit, më datë 08.01.2013. Në bazë të kësaj Marrëveshjeje, Qiradhënësi ka të drejtën e vetme dhe ekskluzive për administrimin e kompleksit, i cili përbëhet nga objekte sportive dhe një hotel që operon nën markën Hotel Rusia, me 4 yje.

Për nevojat e vlerësimit të përqendrimit në fjalë, parashtruesi i njoftimit propozon që tregu relevant të përkufizohet si tregu i akomodimit hotelier me 4 yje në territorin e Qytetit të Shkupit dhe komunave në përbërje të Qytetit të Shkupit

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bjerë nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar lidhur me këtë çështje mbetet i rezervuar.

Komisioni i fton palët e treta të interesuara që t'i dorëzojnë vërejtjet dhe mendimet e tyre lidhur me këtë përqendrim Komisionit. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. „Shën Kirili dhe Metodi“ nr. 54, Shkup, ose me e-mail: kzk@kzk.gov.mk, dhe të njëjtat duhet të arrijnë në Komision brenda afatit prej 10 ditësh nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

23.07.2026

Shkup